

GJITHËPËRFSHIRJA, QËNDRIMET DHE SFIDAT NË MESIN E
EDUKATORËVE PARASHKOLLORË NË KOSOVË

TEMA PËR TITULLIN MASTER I ARTEVE
NË PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM

NGA

BLERTË GASHI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIMI
PRISHTINË

KORRIK, 2021

Gjithëpërfshirja, qëndrimet dhe sfidat në mesin e edukatorëve parashkollorë në Kosovë

Blertë Gashi

Mentori: Zamira Hyseni – Duraku, Prof. Asoc. Dr.

Duke pasur parasysh faktin që mësimdhënësit parashkollorë janë baza e ndërtimit të raportit midis institucionit, prindërve dhe fëmijëve, investimi në të kuptuarit e sfidave të tyre në procesin e inkluzionit dhe faktorët tjerë ndikues në qëndrimet ndaj inkluzionit, është mjaft relevant dhe i domosdoshëm për zhvillimin dhe zbatimin e duhur të praktikave cilësore gjithëpërfshirëse. Prandaj, qëllimi i realizimit të këtij hulumtimi është që të eksplorohej qëndrimet ndaj gjithëpërfshirjes dhe të identifikohen sfidat të cilët hasin edukatorët në institucionet parashkollore në Kosovë. Në këtë hulumtim kanë marrë pjesë 35 edukatorë parashkollorë të cilët punojnë në institucione publike dhe private në Kosovë, me moshë mesatare 30.62 vjeç.

Duke u bazuar në shqyrtimin e literaturës janë parashtruar këto pyetje kërkimore të cilat ky hulumtim do të përpiqet t'i eksplorojë:

1. Si definohet gjithëpërfshirja nga edukatorët parashkollorë në Kosovë?
2. Cila është përvoja e edukatorëve parashkollorë me gjithëpërfshirjen?
3. Cilat janë qëndrimet e edukatorëve parashkollorë për gjithëpërfshirjen e fëmijëve me nevoja të vecanta në institucione parashkollore?
4. Cilat janë sfidat me të cilat përballen edukatorët parashkollorë që në grupin e tyre kanë të

përfshirë fëmijë me nevoja të vecanta?

5. Si ndikon gjithëpërfshirja në mirëqenien psikologjike të edukatorëve parashkollorë?

Kodimi dhe kategorizimi i të dhënave është realizuar përmes softuerit Atlas.it. Të dhënat e mbledhura nga intervistat e strukturuar dhe fokusgrupi janë analizuar përmes analizës klasike të përmbajtjes, në të cilën janë analizuar ekzistimi dhe shpeshësia e koncepteve të njëjta brenda tekstit duke u bazuar në qëllimin e hulumtimit dhe fushat e hulumtuara.

69.0 % të pjesëmarrësve kishin të përfunduar nivelin bachelor të studimeve, ndërsa 13.8 % raportuan që vazhdojnë të ndjekin nivelin master të studimeve, ndërsa 3.4 % e tyre kishin të mbaruar shkollën e mesme.

Në bazë të raportimit të pjesëmarrësve definimi i gjithëpërfshirjes ngërthen në vete këto koncepte kyçe: të qenit i barabartë, e drejta për qasje në institucione arsimore, përfshirje e fëmijëve pa dallim si dhe integrim të fëmijëve me nevoja të vecanta në klasa të rregullta.

Në pyetjen mbi përfshirjen e fëmijëve me nevoja të vecanta në insitucione parashkollore, 31 pjesëmarrës kanë raportuar qëndrime pozitive në raport me përfshirjen e tyre në institucione parashkollore. Ndërsa, në anën tjetër katër pjesëmarrëse raportojnë që fëmijët me nevoja të vecanta duhet të ndjekin institucione të vecanta, duke pasur gjithnjë parasysh komponentën e karakteristikave të fëmiut.

Sipas analizës tematike të intervistave të transkriptuara nga 35 edukatorë të fëmijëve parashkollorë janë konkluduar këto sfida: sfida me prindër, karakteristikat e fëmiut, numri i madh i fëmijëve, mungesa e asistentëve mbështetës, mungesa e trajnimeve si dhe mungesa e materialeve.

Sfidat me prindër, konkludojmë që për të gjithë edukatorët në institucionet parashkollore është shpesh një indikator për stresin e përjetuar dhe mirëqenien psikologjike. Për më tepër, karakteristikat e fëmijut janë po ashtu burime stresi, vecanërisht kur shkalla e vështirësisë së fëmijut është e lartë. Sipas Sukbunpant, Arthur & Dempsey (2013), mungesa e bashkëpunimit me prindërit dhe ngarkesa shtesë e shkaktuar nga mësimi i një fëmije me nevoja të veçanta në klasën e përgjithshme, shihen si disa nga burime të stresit që kontribuojnë në qëndrimet negative ndaj inkluzionit.

Me theks të vecantë, konkludojmë që edukatorët parashkollore cështjen që e adresojnë është mungesa e trajnimeve profesionale për punë me fëmijë me nevoja të vecanta. Në bazë të pyetjeve të të dhënave demografike vërejmë që 36.7 % e pjesëmarrësve nuk kanë ndjekur asnjë trajnim në vitin e fundit në raport me punën me fëmijë me nevoja të vecanta. Ndërsa, 36.7 % të pjesëmarrësve tjerë kanë raportuar që kanë mbajtur një trajnim brenda një viti, për punën me fëmijë me nevoja të vecanta. Sipas konkludimit të Lawrence & Smith, (2016) studiuesit rekomandojnë që kandidatët për mësimdhënës duhet të ndjekin kurse që do t'i pajiste me strategji udhëzuese që mund të jenë ndihmuese përgjatë punës me fëmijë me aftësi të kufizuara dhe mundësi që t'i zbatojnë këto strategji në ambiente gjithëpërfshirëse.

Edukatorët raportojnë që numri i madh i fëmijëve, mungesa asistentëve mbështetës dhe materialeve janë disa nga nevojat që duhet të adresohen për të pasur ambient sa më inkluziv në kopsht. Për një numër të konsiderueshëm të pjesëmarrësve, zbatimi i praktikave inkluzive pa adresim të nevojave të tyre rezultoi që të përbëj në vete një ngarkesë emocionale dhe fizike. Në anën tjetër, për disa nga edukatorët puna me fëmijë me nevoja të vecanta raportohet të prodhojë një satisfaksion të brendshëm në raport me këtë punë.

Nga konkludimet e lartë përmendura si rezultat i intervistave të transkriptuara të analizuara nga 35 edukatorë parashkollorë të cilët punojnë në insitucione publike dhe private në Kosovë: vërehet se edukatorët në institucionet parashkollore kanë nevojë për mbështetje profesionale në raport me qasje ndaj prindërve të fëmijëve me nevoja të vecanta.

Për të pasur një ambient gjithëpërfshirës në insitucione parashkollore rekomandojmë që nevojitet prania e asistentëve mbështetës, ofrimi materialeve specifike konkretizuese si dhe zvogëlim i numrit të fëmijëve në klasa. Po ashtu, e një rëndësie të vecantë është identifikuar edhe mbështetja psikosociale e stafit implementues të insitucioneve parashkollore meqë është raportuar për ngarkesën fizike dhe emocionale që mund të shkaktohen nga përpjekja për krijim të një ambienti gjithëpërfshirës vecanërisht kur ekzistojnë barrierat të ndryshme. Ky hulumtim mëton të shërbej për hulumtimet tjera në këtë fushë si një lehtësues për të pasur një të kuptuar më të thellë të kësaj çështje.